



## NJOFTIM PËR PUNËSIM

**Data e njoftimit: 21/06/2021**

**Programi i GIZ “Shërbime të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime të Orientuara drejt Performancës dhe Konsumatorit”** në bashkëpunim me **Shoqërinë e Ujësjetllës Kanalizimeve Sh.A UK Vlore**, fillojnë zbatimin e projektit **“Punë për komunitetin”** në Bashkinë tuaj me qëllim mbështetjen në këtë kohë të vështirë pandemie të Bashkisë dhe Shoqërisë së Ujësjetllës Kanalizimeve në kuadër të zbutjes së efekteve negative të shkaktuara nga pandemia.

Më hollësisht GIZ do të mbështesë financiarisht dhe me asistencë teknike Shoqërinë e Ujësjetllës për realizimin e një projekti për pastrimin dhe higjienizimin e infrastrukturës së sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe atë të grubullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Duke marrë parasysh se pandemia e Covid-19 rriti numrin e të papunëve duke vështirësuar gjendjen ekonomiko-sociale të shumë familjeve shqiptare, realizimi i këtij projekti parashikohet të realizohet duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të këtyre të papunëve për një periudhë provizore.

Ky projekt do të zgjasë 3 muaj dhe mbështetet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) nëpërmjet GIZ në Shqipëri dhe zbatohet nga Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlore.

Për gjatë 3 muajve projekti do të punësojë një numër përfituesish në komunitet, të cilët do të punojnë kryesisht për pastrimin dhe sistemimin e infrastrukturës së Ujësjetllës Kanalizimeve.

***Nëse jeni të interesuar të ndihmoni komunitetin dhe vendbanimet tuaja, kundrejt një page mujore, jeni të lutur të paraqiteni pranë Zyrave Shoqërisë së Ujësjetllës, deri në datë 30-06-2021, duke patur me vete:***

1. Një kopje të kartës së identitetit dhe adresën e banesës tuaj;
2. Dokument që vërteton aftësinë për punë;
3. Dokument nga Zyra e Punës që vërteton që jeni i papunë;
4. Numrin e llogarisë bankare;
5. Numër kontakti.

**Projekti inkurajon aplikimet nga grupet në nevojë dhe të grave nga këto komunitete.**

**Ju mirëpresim!**



Implemented by **giz** Deutsches Institut für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

